

S T A T U T I I

SHOQERISE

**BASHKEPUNIMIT BUJQESOR
“SHBB HERBS BELSH”**

**Miratar nga Asambleja e Pergjithshme
Belsh me dt. 19/10/2024**

STATUTI

I SHOQERISE BASHKEPUNIMIT BUJQESOR

“SHBB HERBS BELSH”

Sot me date 19/10/2024, Grupi nismetar i perbere prej 8 (tete) anetare ne mbeshtetje te ligjit nr. 38 dt. 05.04.2012 “Per Shoqerite e Bashkepunimit Bujqesor” si dhe te ligjit nr. 9723 dt.03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, hartohet ky Statut i Shoqerise Bashkepunimit Bujqesor “SHBB HERBS BELSH”, me vullnetin e lire te anetareve te saj.Kjo Shoqeri eshte nje organizem jo politik dhe i pavarur.

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqerise do te jete :

“ SHOQERIA E BASHKEPUNIMIT BUJQESOR “SHBB HERBS BELSH”

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete objektin e saj te veprimtarise si me poshte :

1. Shtimin e siperfaqeve me bime medicinale, grumbullimin, perpunimin dhe tregtimin e tyre.
2. Ngritjen dhe modernizimin e ambjenteve frigoriferike gjithëvjetoare e gjithëperfshirese ne fushen e bujqesise, per efekt ruajtje, tregtimi, eksport-import.
3. Mbjellje, rritje, perkujdesje te gjithe spektrit te bimeve mjekesore dhe aromatike, grumbullim, perpunim dhe tregtim te tyre.
4. Import-eksport te bimeve mjekesore dhe aromatike, te fresketa dhe te thata.
5. Ngritjen e industrise perpunuese te bimeve mjekesore e aromatike.
6. Blerjen brenda dhe jashte vendit te impianteve te mekanikes bujqesore dhe imputeve te ndryshme ne funksion te bujqesise zones, rrethit e me tej.
7. Do te kemi ne vemendje rritjen e biodiversitetit dhe rritjes se drufrutoreve dhe pyjeve, per te rritur e mbrojtur siperfaqen gjelberuese e minimizimin e ndotjes se mjedisit.

8. Per gjithcka qe trajton ligji per SHBB-te ne qender te vemendjes do te jete edhe zhvillimi i bujqesise biologjike ne pergjithesi, bimeve etero-vajore, bimeve spontane ne natyre dhe erezave sipas ligjit Shqiptar ne fuqi dhe rregullores se Bashkpunimit European per Mbeshtetje te reja ne drejtim te Import-Eksporteve.
9. Nje sektor i vecante do te kete ne fokus transparencen, rritjen e siperfaqes organike dhe mbrojtjen e mjedisit.

NENI 3

PERGJEGJESIA E SHOQERISE

Shoqeria pergjigjet per detyrimet me gjithë pasurine e saj. Ortaket jane pergjegjes per detyrimet e shoqerise deri ne vleren e kontributit te tyre te nenshkruar ne kapitalin e shoqerise.

NENI 4

SELIA DHE TERITORI I VEPRIMTARISE

Selia e Shoqerise do te jete ne qytetin e Belshit.

Veprimtaria e saj do te zhvillohet ne teritorin e Bashkise Belsh, Fshati Çepe, Rruga Belsh-Kosove, godina nr.121/4, kati i pare.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise (SHBB) “SHBB HERBS BELSH” do te jete e pakufizuar.

NENI 6

KUSHTET E PRANIMIT TE ANETAREVE

1. Shoqeria fillimisht ka anetaresuar 8 (tete) anetare.
2. Ne Shoqerine Bashkepunimi Bujqesor mund te anetaresohet cdo individ qe permbush kushtet e pershkruara ne kete Statut dhe ne Ligjin perkates te SHBB-ve, cdo person fizik apo Juridik me shtetesi Shqiptare, duke paguar edhe kontributin perkates, ashtu si grupi nismetar dhe cdo person qe eshte i interesuar per misionin e shoqates.
3. Vendimin per pranimin e anetareve te rinj e merr Asambleja e Pergjithshme e SHBB-se.
4. Anetari i ri detyrohet sapo merr anetaresimin:
 - Pagan kontributin dhe kapitalin
 - Pranon Statutin dhe Stafin drejtues te SHBB-se

5. Kur nuk paguan kontributin vendimi i anetaresimit shfuqizohet menjehere dhe kerkuesi duhet te aplikoje nga e para.
6. Gjate periudhes 30-ditore, anetari i miratuar nuk ka te drejte vendimore deri ne momentin e realizimit te detyrimeve te kapitalit dhe pageses te ketij kontributi.

NENI 7

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ANETAREVE

1. Anetaret kane te drejta e detyra te percaktuara qarte.
2. Kane te drejte te propozojne dhe miratojne rregullat e funksionimit te brendshem te Shoqerise.
3. Kane te drejten te propozojne e te miratojne ndryshimet ne statut.
4. Kane te drejten e informimit ne cdo kohe per ecurine e rezultatet e Shoqerise, duke perfituar cdo akses te dokumentuar.
5. Kane te drejte te marrin pjese ne mbledhjet e Asamblese e te diskutojne.
6. Kane te drejte te largohen nga Shoqeria sipas percaktimit specifik ne kete statut.
7. Anetaret kane detyrimin te paguajne kontributin perkates ne kapitalin e Shoqerise.
8. E drejta e analizes ne Shoqeri mund te tjetersohet duke u dhuruar, shitur apo te kalohet me ane trashigimie pergjithmone ne perputhje me parashikimet e ligjit per Shoqerite e Bashkpunimit Bujqesore.
9. Cdo antar ka te drejte te shfaqe mendimin e tij, te diskutoje ne mbledhje, te kerkoje llogari per harxhimin e fondeve, te kundershtojne ne Gjykaten Kopetente vendimet e Shoqerise qe vijne ne kundershtrim me ligjin dhe statutin, brenda nje muaji nga dita qe ka marre njoftimin per ate vendim.
10. Anetaret kane te drejte te propozojne ndryshimin e Administratorit te Shoqerise, te informohen per llogarite vjetore financiare, per raportet e Eksperteve Kontabel, menytrat dhe procedurat e ndarjes se fitimit, raportin e veprimtarise se Shoqerise si dhe cdo te drejte apo detyrim tjetere qe eshte ne ligj.

NENI 8

RIMBURSIMI I ANETAREVE TE LARGUAR APO PERJASHTUAR

1. Anetaret qe kane dhene dorheqjen ose jane perjashtuar nga Shoqeria kane te drejten te rimbursohen per pjesen e tyre te kapitalit, me perjashtimin e rastit ku kane detyrime te pashlyera kundrejt Shoqerise apo kur i kane sjelle nje dem financiar te konfirmuar Shoqerise.
2. Rimbursimi do te behet pa prekur pjesen e kapitalit minimal prej 100.000 lekesh te percaktuar nga ligji.
3. Rimbursimi do te behet jo me vone se 5(pese) vjet nga dita e largimit apo e perjashtimit te tij nga Shoqeria.
4. Ne rast te kalimit 5 (pese) vjecar, antari i larguar apo perjashtuar ka te drejten ta kerkoje rimbursimin ne rruge gjyqesore.

NENI 9

OFRIMI I SHERBIMEVE

1. Shoqeria ofron sherbimet e saj jo vetem per anetaret e saj por dhe per individe, persona fizike apo juridike qe nuk jane anetare te Shoqerise.

2. Per personat jo anetare ofrimi i sherbimeve nga Shoqeria do te jete me vlere jo me te ulet se sa cmimet e tregut.
3. Ne cdo rast, te ardhurat qe Shoqeria krijon si pasoje e ofrimit te sherbimeve te saj atyre qe nuk jane antare te saj nuk duhet te kaloje masen e 40% te Totalit te te ardhurave te Shoqerise.

NENI 10

KAPITALI

1. Kapitali minimal i Shoqerise eshte 100 000 leke. Kapitali i Shoqerise perbehet nga Kontributet e anetareve te cilet mund te jene ne para ose ne natyre.
2. Kapitali ndahet ne pjese te cilat zoterohen nga antaret dhe perfaqesojne vleren e kontributeve te tyre ne kapital.
3. Ky kapital eshte i ndare ne 8 kuota ku nje kuote eshte e barazvlefshme me nje anetar.
4. Kontributet ne natyre shprehen ne vlere ekonomike mbi bazen e nje raporti vleresimi te bere nga nje ekspert.
5. Antaret jane pronare te asetave te tyre ne kapitalin e Shoqerise ne raport me kontributet ne kapital.
6. Kapitali perkates mund te shitet, dhurohet apo lihet ne trashegimi nga secili prej anetareve te Shoqerise
7. Kapitali perkates mund te ndryshoje me ane te kontributeve shtese te anetareve aktual me shtimin e numrit te anetareve, me kapitalizimin e fitimeve apo me cdo menyre te ligjshme.

Ne momentin e krijimit te shoqerise kapitali fillestar eshte i ndare si me poshte:

Nr.	Emri, Mbiemri	Kapitali ne vlere ne leke	Ne %	Kuote per secilin
1	ILIR FIQIRI SHTYLLA	25.000	25 %	1
2	FIQIRI SELMAN SHTYLLA	1.000	1 %	1
3	SKENDER SELMAN SHTYLLA	1.000	1 %	1
4	HEKURAN VEIZ PASHTANJAKU	1.000	1 %	1
5	NEIM SELMAN SHTYLLA	1.000	1 %	1
6	LULZIM VEIZ PASHTANJAKU	1.000	1 %	1
7	OLTJON JEMIN SHTYLLA	10.000	10 %	1
8	SANDRA ILIR SHTYLLA	60.000	60 %	1
	TOTALI	100 000	100 %	8

8. Cdo anetare ka detyrimin te shlyeje plotesisht vleren e kontributit te tij ne momentin e anetarsimit.

NENI 11

TRANSFERIMI I KAPITALIT

1. Pjesa e kapitalit ne Shoqeri fitohet ose trashegohet duke pasur parasysh percaktimet e ligjit nr. 38 dt.05.04.2012 “Per Shoqerite e Bashkepunimit Bujqesor” nepermjet :
 - a. Nenshkrimit te kontributit ne kapitalin e Shoqerise.
 - b. Dhurimit.
 - c. Trashegimise kur te interesuarit kerkojne te jene anetare.Transferimi i pjeses tek te interesuarit qe gezojne cilesine e trashegimtarit dhe qe kerkojne te jene anetare behet brenda 6 muajve nga vdekja e antarit.Ne rastet kur nuk permbushet kushti i siperpermendur ata kane te drejte te kerkojne likujdimin e pjeses perkatese.
 - d. Cdo forme tjeter e parashikuar me ligj.

NENI 12

FONDI I REZERVES SE DETYRUESHME

1. Shoqeria krijon fondin e Rezerves se Detyrueshme, i cili destinohet per konsolidim dhe garancine e kapitalit te Shoqerise se Bashkepunimit Bujqesor e te aftesise paguese te saj dhe eshte i pandashem ndermjet anetareve dhe i patransferueshem, pervec rasteve te parashikuara ne nenin 56 te ligjit nr.38 dt.04.05.2012 “Per Shoqerite e Bashkepunimit Bujqesor”
2. Fond i Rezerves se detyrueshme krijohet nga derdhja ne kete fond e jo me pak se 15% te fitimit neto, te realizimit gjate vitit financiar paradhenes, pasi te jene zbritur humbjet e mbartura ne masen deri sa kjo rezerve te jete e barabarte me kapitalin e Shoqerise, sipas nenit 24 te ligjit nr. 38 dt. 04.05.2012 “Per Shoqerite e Bashkepunimit Bujqesor”

NENI 13

FONDI I PERBALLIMIT TE RISKUT

1. Shoqeria krijon fondin e PERBALLIMIT TE RISKUT qe sherben per perballimin nga Shoqeria te rreziqeve apo demeve te cfaredolloj natyre, me te cilat mund te perballtet veprimtaria e Shoqerise, perfshire ketu fenomenet natyrore apo ato deme dhe risqe, te cilat jane te lidhura me vete llojin e veprimtarise ose produktit.
2. Shoqeria depoziton ne fondin e perballimit te riskut nje perqindje te fitimit te saj, e cila percaktohet ne statut, por qe nuk mund te jete me pak se 10% e fitimit neto te realizuar gjate vitit paraardhes, pasi te jene zbritur humbjet e mbartura.Ky fond eshte i pandashem nepermjet antareve dhe i patransferushem pervec rasteve te parashikuara ne nenin 56 te ligjit nr.38 dt. 04.05.2012 “Per shoqerite e Bashkepunimit Bujqesor”

NENI 14

DOKUMENTACIONI DHE KONTABILITETI

1. Shoqeria mban te dhena te veprimtarise se saj ne:
 - a. Regjistrin e antareve
 - b. Regjistrin e vendimeve te organeve te saj
 - c. Regjistrat per veprime financiare dhe kontabel

2. Shoqeria mban kontabilitetin e veprimtarise se saj ekonomike ne perputhje me ligjin nr. 9228 dt.29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare "Te ndryshuar"
3. Administratori pergatit raportin e veprimtarise, inventaret dhe llogarite vjetore ne perputhje me legjislacionin kontabel, te cilat i paraqiten Asamblese se Pergjithshme per miratim.
4. Mbajtja e regjistrave te Shoqerise eshte nen pergjegjesine e Administratorit, menytrat dhe afatet e ruajtjes se tyre percaktohen ne rregulloren e brendshme te Shoqerise.

NENI 15

ORGANET DREJTUESE, MENYRAT E FORMIMIT, KOMPETENCAT

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE JANE:

1. Asambleja e Pergjitheshme
2. Presidenti ose Administrator i SHBB-se
3. Sekretari i SHBB-se
4. Ekonomisti (Kontabel i miratuar)

1. ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- Asambleja e Pergjithshme eshte Organ vendimarrës dhe perbehet nga te gjithe antaret e Shoqerise.
- Asambleja zgjedh me shumicen e thjeshte te antareve te saj Administratorin (Presidentin) dhe Sekretarin e saj per nje periudhe 5 vjecare.

ASAMBLEJA KA KETO KOMPETENCA

1. Vendors drejtimin e politikave te Shoqerise.
2. Analizon raportin e gjendjes financiare vjetore, perfshire llogarite vjetore, shperndarjen e fitimeve, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe ceshtje te tjera te veprimtarive ekonomike, qe konsiderohen te rëndësishme.
3. Emeron dhe shkarkon Administratorin, Ekspertin/et kontabel dhe likujduesin/it, si dhe percakton masen e shperblimit te tyre.
4. Miraton zvoglimin apo zmadhimin e kapitalit.
5. Miraton ndryshimet ne Statut.
6. Vendors per shperndarjen apo menyren e perdorimit te fitimit te Shoqerise sipas dispozitave ne Statut.
7. Vendors shkrijen, ndarjen, transformimin apo shperndarjen e Shoqerise.
8. Vendors per ndryshimet e Struktures ekonomike, shoqerore, organizative apo funksionale te Shoqerise.
9. Vendors per pjesmarrjen ne forma te tjera te bashkepunimit ekonomik dhe me ane te pjesmarrjes ne kapital, aderimin ne organizata me karakter perfaqesues dhe shkeputjen e tyre.
10. Miraton pasqyrat financiare, raportet per mbarvajtjen e veprimtarise se shoqerise dhe largimin apo perjashtimin e tyre.
11. Miraton pranimin e antareve te rinj dhe pjesmarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqerise si dhe largimin apo perjashtimin e tyre.
12. Kryen detyra dhe ceshtje te tjera te percaktuara ne ligj, si dhe bashkpunon me eksperte kontabel.Per ceshtjet qe shqyrton Asambleja e Pergjithshme merr vendimet perkatese, te cilat jane te ndryshueshme per te gjithe antaret e Shoqerise.Ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme cdo kuote ne kapital eshte baraz me te drejten e nje vote.

13. Thirrja e Asamblese, menyra e votimit, perfaqesimi dhe korumi behen sipas procedurave te percaktuara ne ligjin nr. 38 dt. 04.05.2012 "Per Shoqerite e Bashkepunimit Bujqesor"

2. ADMINISTRATORI

- Administratori i SHBB "SHBB HERBS BELSH" me vendim te Asamblese eshte zgjedhur :
Sandra Shtylla e identifikuar me numer leternjoftimi 038740010.
- Administratori eshte person i cili ka pergjegjesi per mbarvajtjen e aktivitetit te Shoqerise. Ai perfaqeson Shoqerine ne lidhje me palet e treta.
- Administratori qendron ne detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

KOMPETENCAT KRYESORE TE ADMINISTRATORIT

- Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise se Shoqerise, duke zbatuar politikat e percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
- Perfaqeson Shoqerine.
- Kujdeset per mbarvajtjen e sakte te rregullit te dokumentave, te regjistrave dhe te librave kontabel te Shoqerise.
- Pergatit dhe nenshkruan Bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar per raportin e ecurise se veprimtarise dhe sebashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ai paraqet keto dokumenta Asamblese se Pergjithshme per miratim.
- Krijon nje sistem informimi dhe vleresimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit sipas ligjit nr.38 dt.04.05.2012 "Per Shoqerite e Bashkepunimit Bujqesor".
- Raporton ne Asamble sipas kerkesave te Asamblese se anetareve.
- Asambleja e Pergjithshme mund ta shkarkoje Administratorin ne cdo moment me shumice te thjeshte votash pa u trajtuar kjo si ndryshim i statutit.
- Administratorit te cilit i ka mbaruar mandati i plote i emerimit kryen vetem ato detyra te cilat jane te nevojshme per permbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e Shoqerise deri ne emerimin e Administratorit te ri.

KOMPETENCAT E SEKRETARIT

Sekretari i SHBB "SHBB HERBS BELSH" me vendim te Asamblese eshte zgjedhur

Z. Oltjon Shtylla

- Do te merret me te gjitha procedurat e regjistrimit, administrimit dhe drejtimit teknik te kesaj Shoqerie i cili vepron dhe raporton perpara Administratorit te Asamblese.
- Vepron ne organet shteterore e vendore i autorizuar nga Administratori, perpara organeve te ndryshme shteterore, vendore e shoqerore.

KOMPETENCAT E EKSPERTIT KONTABEL

- Eksperti Kontabel i SHBB "SHBB HERBS BELSH" me vendim te Asamblese do te jete z. Ismail Lleshi, Ekspert Kontabel i Autorizuar me Licence nr. 267 dhe numer NIPTI K82202015Q.
- Do te raportoje periodikisht ne Asamble dhe perpara Administratorit me shkrim dhe te dokumentuara ne cdo problem ekonomik -financiare.

- Do te depozitoje bilancet sipas tipit te percaktuar ne ligjin per SHBB-te ne organet perkatese tatimore.
- Per cdo neglizhence e per cdo paaftesi profesionale do te pergjigjet perpara organeve shtetere dhe te SHBB-se deri ne shkarkim nga puna.
- Per kete qellim do te kete nje marrveshje dypaleshe me SHBB-ne me perfaqses Administratorin ne periudha te caktuara vjetore, per formen ,kohen e punesimit zyrtar dhe te pageses se tij, duke mbajtur pergjegjesi ligjore-fiskale per anen dokumentare tip per SHBB-te.

NENI 16

PRISHJA E SHBB “SHBB HERBS BELSH “

Shoqeria shkrihet dhe hyn ne proces likuidimi per shkaqet e meposhtme:

1. Perfundimi i afatit te Shoqerise, sipas percaktimeve te Statutit.
2. Vullneti i anetareve i manifestuar nepermjet vendimit te Asamblese se Pergjithshme.
3. Permbushja e plote e objektit te Shoqerise ose pamundesia per ta permbushur ate.
4. Zvogelimi i numrit te antareve nen minimumin ligjor te nevojshem, per te krijuar nje Shoqeri, sipas dispozitave te ligjit, nese numri i nevojshem i anetareve nuk rivendoset brenda nje periudhe prej 6 muajsh.
5. Bllokimi i veprimtarise vendimarrse te ndonjerit prej organeve te Shoqerise ose mosustrimi i veprimtarise se Shoqerise per nje periudhe te vazhdueshme 5-vjecare.
6. Reduktimi i kapitalit te Shoqerise nen minimumin e percaktuar ne ligj, nese nuk rivendoset ne nje periudhe 6-mujore.
7. Nisja e procedurave te falimentimit.
8. Mosustrimi i veprimtarise per nje periudhe te vazhdueshme 5-vjecare dhe mos njoftimi i pezullimit te veprimtarise ne perputhje me ligjin nr.9723 dt. 03.05.2007 “Per Qendren kombetare te Regjistrimit”.
9. Nese Shoqeria rezulton me humbje per nje periudhe te vazhdueshme 5-vjecare.
10. Me vendim te Gjykates.
11. Per cdo arsye tjeter te percaktuar me ligj.

NENI 17

LIKUJDIMI

1. Pervec rasteve kur kundrejt Shoqerise eshte hapur nje procedure falimentimi ndaj nje personi juridik, sipas dispozitave te ligjit nr. 8901 dt.23.05.2002 “Per falimentimin” te ndryshuar, verifikimi i nje prej shkaqeve te permendura ne nenin nr.15 te ketij ligji ka si pasoje hapjen e fazes se likujdimit te shoqerise ne gjendjen e aftesise paguese.
2. Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Asambleja e Pergjithshme nese Asambleja e Pergjithshme nuk merr nje vendim per emerimin e Likujduesit brenda 30 diteve pas vendimit te prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidator.
3. Cdo person i interesuar ka te drejte ti kerkoje Gjykates zevendesimin e Likujduesit nese paraqet arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likujdimi i rregullt i Shoqerise mund te cenohet nga likujduesit e emeruar me siper.
4. Cdo person i interesuar ka te drejte ti kerkoje Gjykates zevendesimin e Likujduesit te emeruar sipas paragrafeve 1 dhe 2 te ketij neni nese paraqet arsye te mjaftueshme per te dyshuar se

likujdimi i rregullt i Shoqerise mund te cenohet nga Likujdueset e emeruar si me siper, kerkesa duhet te depozitohet ne Gjykate brenda 30 diteve nga data e caktimit te likujdimit.

5. Likujduesi emerohet nga Gjykata ne raste kur Shoqeria priset me vendim te Gjykates.

NENI 18

Ky Statut hyn ne fuqi dite ne Regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, dite ne te cilen Shoqeria njihet edhe si Person JURIDIK.

PERFAQESIA THEMELUESE

Nr.	Emri, Mbiemri	Nr. I Kartes Identitetit	Nenshkrimi Emer,mbiemer,firmë
1	ILIR FIQIRI SHTYLLA	H71107005C	Ilir Shtylla
2	FIQIRI SELMAN SHTYLLA	F40506004R	Fiqiri Shtylla
3	SKENDER SELMAN SHTYLLA	G51001005M	Skender Shtylla
4	HEKURAN VEIZ PASHTANJAKU	G30418207S	Hekuran Bushkaj
5	NEIM SELMAN SHTYLLA	F90306010O	Neim Shtylla
6	LULZIM VEIZ PASHTANJAKU	H70714014G	Lulzim Bushkaj
7	OLTJON JEMIN SHTYLLA	I60707014R	OLTJON SHTYLLA
8	SANDRA ILIR SHTYLLA	K56114010P	Sandra Shtylla


Kryetari

SANDRA SHTYLLA

Neim Shtylla



Figiri Shtylla



Skender Shtylla



Hekuran Pashtanjaku



Lulzim Pashtanjaku



Oltjon Shtylla



Ilir Shtylla